



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:104001

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05812443

C.nr.343/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, me bashkëpunëtoren profesionale Adelina Çmega, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.G nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit, të cilin e përfaqëson av. S.B nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, ndaj të paditurës B, të cilën e përfaqëson S, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar A.A, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të objektit të kontestit – kompensimi i dëmit material me vlerën e objektit të kontestit prej 1,700.00 euro, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më datën 27.05.2024 morri, ndërsa më datën 12.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit B.G nga fshati Hoçë e Vogël, Komuna e Rahovecit,

II. DETYROHET e paditura B, që paditësit B.G, në emër të kompensimit të dëmit material, të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 26.07.2021, në rrugën Landovicë - Prizren, në automjetin B1, me targa ..., t'ia kompensojë shumën prej 686.00 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga data 20.05.2022 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. REFUZOHET si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e paditësit B.G, në emër të kompensimit të dëmit material, përtej shumës së aprovuar prej 686.00 euro deri në shumën prej 1,700.00 euro, dhe atë në shumën prej 1,014.00 euro.

IV. DETYROHET e paditura B, që në emër të shpenzimeve procedurale, paditësit B.G, t'ia paguaj shumën prej 544.00 euro, po ashtu, në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësi B.G, përmes përfaqësuesit të autorizuar më datën 20.05.2022, në këtë gjykata ka parashtruar padinë ndaj të paditurës B, për shkak të objektit të kontestit – kompensim i dëmit material, me vlerën e objektit të kontestit prej 1,700.00.

Paditësi përmes të përfaqësueses të tij të autorizuar av. Sarandë Beqiri, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare, ka theksuar se mbesin në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadsisë, në të cilën baza nuk është kontestuar, mirëpo kontestuese është vetëm lartësia e saj. Gjykatës i ka propozuar që të nxirret ekspertiza e makinerisë, në të cilën eksperti do të përcaktojë dëmet të cilat janë shkaktuar në makinë, riparimet dhe kostot e dëmit që i është shkaktuar paditësit në mënyrë që të rivendoset gjendja e mëparshme para shkaktimit të aksidentit. Pas pranimit të ekspertizës lidhur me vlerësimin e dëmit të shkaktuar në automjetin e njëjta ka theksuar se pjesërisht e kontestojmë, konkretisht sipas palës nuk është bërë vlerësimi i plotë i dëmeve, në pjesën e bagazhit të veturës dhe mënyrën se si është rregulluar mbrojtësi i pasmë, të cilat kanë rezultuar edhe me vlerësimin në shuma joreale të dëmit të shkaktuar. Andaj për këto arsye ka kërkuar plotësimin e ekspertizës edhe në këto dy pika dhe sipas mundësisë të shikohet edhe vetura e palës, pasi që sipas tij, nga fotografitë nuk mund të verifikohen dhe vlerësohen këto dëme. Duke shtuar se kontestuese në këtë çështje ka qenë vetëm lartësia e dëmit, për të cilën pala pretendon se është dëmi real në automjet, pa llogaritur punën e dorës, 1,200.00 Euro, që palës i kanë kushtuar në riparimin e veturës. E njëjta ka theksuar se në këtë dëm të pretenduar në fazën e procedurës administrative ishte vlerësuar me ofertën e tretë në shumë prej 950.00 Euro, gjatë negociimit me palën e paditur, andaj në këtë drejtim vlerësojnë se lartësia e kërkesëpadsisë, duke llogaritur të gjithë koston deri në riparimin final, ka arritur shumën prej 1,700.00 Euro.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura B, të cilën e përfaqëson S”, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar A.A, në përgjigjen në padi, në shqyrtimin kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se për të paditurën nuk ka qenë kontestuese baza juridike, por vetëm lartësia dhe për të njëjtën i kemi dhënë edhe ofertë. I njëjti ka theksuar, meqenëse përfaqësuesja e paditësit ka deklaruar se në procedurë administrative i është edhe oferta e tretë në shumë prej 950.00 Euro, përmes telefonit dhe të njëjtën nuk e kanë pranuar, konsiderojnë se i padituri në këtë rast nuk i ka dhënë shkas padisë, pasi ka qenë i gatshëm që ta përmbush obligimin e tij, andaj nuk i takojnë shpenzimet procedurale. Gjykata i ka propozuar që të ia falë besimin ekspertizës, si dhe ta refuzojë padinë mbi shumat të cilat i kërkon pala paditëse.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor - publik të datës 27.05.2024, sipas propozimit të palëve ka administruar provat dhe atë: Vendimin e datës 27.08.2021, i Komisionit të Shkallës së Parë për Trajtimin e Dëmeve, i të paditurës; raportin e aksidentit me nr. 2021-GR-527, i datës 26.07.2021, i Njësitit të Trafikut; certifikatën e regjistrimit të automjetit CRA1506974, me numër të targave ...; konfirmimin e sigurimit të datës 10.08.2021, i I dhe ekspertizën e vlerësimin të dëmit (makinerisë), e ekspertit B.K, e dorëzuar në këtë gjykatë me datë 29.03.2024.

Gjithashtu ka angazhuar dhe ekspertin e makinerisë B.K, si dhe këtë ekspertizë e ka procedurë tek palët ndërgjyqëse.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 7 dhe 8 i LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se me datën 26.07.2021, rreth orës 14:30 min, në rrugën Landovicë - Prizren, është shkaktuar aksidenti i trafikut me dëme materiale, i cila fakt është vërtetuar edhe nga raporti i aksidentit numër 2021-GR-527, i datës 26.07.2021.

Në këtë çështje kontestimore ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë, por kontestuese ka qenë lartësia e kërkesëpadisë.

Me administrimin e konfirmimit të sigurimit i datës 10.08.2021, i I, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi B.G, ka pasur validitetin e sigurimit të automjetit për periudhën kohore nga data 28.09.2020 – 28.09.2021.

Me administrimin e ekspertizës së vlerësimit të dëmit të ekspertit B.K, të dorëzuar në gjykatë me datë 29.03.2024 si dhe sqarimeve të tij në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 27.05.2024 (të cilëve gjykata ia dha besimin e plotë) gjykata vërtetoi faktin, se në bazë të shkresave e lëndës, fotografive të automjetit të dëmtuar, çmimit të pjesëve të automjetit, që i referohet çmimit të tregut për blerje të pjesëve, çmimit për riparim, katalogut “Quattrorute, hulumtimeve në internet, si dhe normativit në bazë të katalogut dhe faturës, është konstatuar se dëmi i shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 26.07.2021, në automjetin e markës B1, me targa të regjistrimit ..., pronë e paditësit B.G, është në shumë prej 686.00 euro.

Gjykata ekspertizën e punuar nga i eksperti i makinerisë B.K, e vlerëson si profesionale, të argumentuar mirë dhe të njëjtës ia fali besimin e plotë, ngase e njëjta ka paraqitur vlerësime profesionale lidhur me dëmin e shkaktuar në automjetin i cila është objekti i kompensimit të dëmit në këtë çështje kontestimore.

Gjykata vendosi ta aprovojë pjesën e kërkesëpadisë së paditësit për faktin se sipas vlerësimit të saj në këtë çështje juridike kontestimore kemi të bëjmë me shkaktimin e dëmit material, si pasojë e aksidentit të komunikacionit të shkaktuar nga i automjeti i cili në kohën e shkaktimit të aksidentit nuk ka qenë i siguruar. Baza e kërkesëpadisë është përcaktuar sipas nenit 136 par. 1 i LMD-së përcaktohet se “*Kush i shkaktonte tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, ndërsa sipas nenit 18 par.1 dhe 4 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia Nr.04/L-018 përcaktohet se “*Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i auto përgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e dëmit nga Byroja*”, dhe par.4 “*Byroja ka të drejtë regresi për këto dëme nga personi përgjegjës dhe atë për shumën e paguar, shpenzimet dhe kamatat*”. Ndërsa lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar sipas ekspertizës të vlerësimit të dëmit, të ekspertit B.K, të dorëzuar në këtë gjykatë më datën 29.03.2024, si dhe sqarimeve të ekspertizës në seancën e

shqyrtimit kryesor, sipas së cilën është konstatuar se në aksidentin e komunikacionit të datës 26.07.2021, dëmi material i cili i është shkaktuar paditësit B.G, në automjetin B1, me targa ..., është në shumën prej 686.00 euro, andaj gjykata vlerëson se kjo shumë edhe i takon paditëses në emër të ribursimit të dëmit për këtë automjet.

Gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e refuzuar pjesën e kërkesëpadisë në emër të dëmit material të shkaktuar në automjetin e markës B1, përtej shumës prej 686.00 euro deri në shumën prej 1,700.00 euro, dhe atë në shumën prej 1,014 euro, për faktin se në këtë çështje kontestimore dhe atë sipas ekspertizës së vlerësimit të dëmit është konstatuar se dëmi i shkaktuar në automjet është në shumën prej 686.00 euro dhe jo shuma prej 1,700 euro, siç pretendon paditësja, andaj gjykata edhe e ka refuzuar pjesën e kërkesëpadisë në shumën prej 1,014.00 euro.

Sa i përket propozimit të përfaqësueses së autorizuar të paditëses për kthimin e eksertizës së makinerisë në plotësim me arsyetimin se nuk është bërë vlerësimi i plotë i dëmit, kjo gjykatë e ka refuzuar një propozim të tillë për faktin se ekspertiza e ekspertit të makinerisë ka qenë e punuar në mënyrë profesionale dhe ka qenë e bazuar në shkresat. Gjykata e ka refuzuar këtë propozim për shkak se paditësja nuk ka ofruar prova të reja me të cilat do të krijoheshin rrethanat e reja e të cilat nuk kanë qenë të njohura kur është përpliluar ekspertiza.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimi lidhur me lartësinë e kamatës është marrë duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 të LMD-së.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike të cekur më lartë, e duke u bazuar në dispozita të neneve 136, të LMD-së, nenit 18 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, dhe duke u mbështetur në dispozitat e neneve 143, 323, dhe 390 të LPK-së ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Vendimin në lidhje me shpenzimet procedurale gjykata e morri duke u mbështetur në dispozita e neneve 449 dhe 450.2 të LPK-së.

Nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil
C.nr.343/2022, më datë 12.06.2024

Bashkëpunëtore profesionale
Adelina Çmega

Gjyqtari
Berkan Hamza

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.